

Rëndësia e turizmit në rritjen ekonomike të Republikës së Kosovës



Economy - Tourism

Fjalë kyçe: turizëm, zhvillim ekonomik, infrastrukturë, Kosova, marketing, etj.

Alush Kryeziu

MTI Department of Commerce, Prishtina, Republic of Kosova

Abstract

Turizmi është veprimtari e cila ka baza në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Potencialet dhe resurset me të cilat disponon Kosova janë kushtet të cilat ndikojnë në zhvillimin e tij. Me qen se vendi gjendet në periudhën e tranzicionit mu atëherë duhet të orientohet në zhvillimin turizmit duke u bazuar në potencialet dhe resurset në dispozicion. Nëse duhet zhvilluar infrastruktura turistike duhet qasur hulumtimeve të bazuara në marketingun turistik. Nëse baza duhet të qasur edhe legjisllacionit sa është në favor të turizmit. Të gjitha do të jenë në shërbim të ngritjes së brutoproduktit dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Hyrje

Bazuar në faktin që Kosova si shtet i ri gjendet në tranzicione dhe posedon vende të shumta turistike dhe rehabilitues, të cilat përmbajnë veti shëruese kanë ndikim që Kosova të bëhet më atraktive dhe tërheqëse për tu vizituar. Nevoja për investime në sektorin e turizmit është gjithnjë e më e kërkuar, pasi që turizmi është veprimtari e rëndësishëm e zhvillimit ekonomik të një vendi, po ashtu me ngritjen dhe përmirësimin e kushteve për turizëm do të bëhen një gërshetim i prezantimit të imazhit dhe kulturës së vendit duke u vizituar nga vizitorë të ndryshëm. Zhvillimi i turizmit në Kosovë si njëra ndër vendet më të varfra të rajonit dhe më shkallë më të lartë të papunësisë, do të ishte një indikatorë i rëndësishëm për zbutjen e shkallës së papunësisë dhe ngritjen e të ardhurave të vendit. Edhe pse Kosova nuk ka bregdetë mundësi për turizëm është e madhe, si në bukuritë natyrore po ashtu dhe në monumentet historike dhe kulturore.

Turizmi dhe zhvillim ekonomik

Definicioni i turizmit si veprimtari ekonomik ka rëndësi të madhe së pari duke u bazuar në definicionet e turizmit me të cilat ndërlidhet aspekti ekonomik i tij. Në aspektin e gjerë shoqëror dhe politik, ku roli i turizmit si veprimtari ekonomik është shumë i rëndësishëm. Në lidhje me këtë ekzistojnë mendime të ndryshme nga të cilat jepet një bazë e rëndësishme e turizmit si veprimtari ekonomik. Turizmi është i lidhur me shumë degë dhe disiplina shkencore të ndryshme të cilat janë ndërlidhura mes tyre. Kjo ka të bëjë me aspektin ekonomik të ndërlidhur me këtë veprimtari. Të gjitha lëndet të cilat ndërlidhën me ekonominë e turizmit orientimi i tyre është i drejtuar ka turizmi si veprimtari ekonomik. Bazuar në këtë mundësi të parashihet se në njërin anë janë turistët të cilët njëkohësisht janë konsumues të shërbimeve turistike të cilët disponojnë me para për të paguar shpenzimet dhe në anën tjetër është ekonomia turistike, e cila duhet të jetë në shërbim të nevojave turistike. Turizmi luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendeve në tranzicion dhe zhvillim. Kosova e ka njohur potencialin e turizmit vendor për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Gjendja e ekonomisë vendore dhe vendi i turizmit si veprimtari ekonomike

Bazuar në të dhënat në dispozicion për vendet e Evropës Juglindore (EJL), rimëkëmbja ekonomike gjatë vitit 2011 paraqitet e moderuar. Kosova shënoi normën më të lartë të rritjes me 5.0 përqind, pasuar nga Maqedonia me 3.2 përqind. Po ashtu, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, dhe Serbia regjistruan rritje të PBB-së me normë reale prej 3.0, 2.7, 2.4, dhe 1.6 përqind. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave të shkaktuara nga luhajtjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë evropiane. Aktiviteti ekonomik në vend karakterizohet me stabilitet kur merren parasysh burimet kryesore të financimit shumica e të cilave kanë treguar performancë të mire. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave të shkaktuara nga luhajtjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë evropiane. Aktiviteti ekonomik në vend karakterizohet me stabilitet kur merren parasysh burimet kryesore të financimit shumica e të cilave kanë treguar performancë të mirë (Figura 1). Sidoqoftë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në disa prej vendeve të eurozonës rezultoi në ngadalësim të eksporteve të mallrave, rritja e të cilave gjatë vitit 2011 ishte vetëm 6.3 përqind. Në anën tjetër, dërgesat e emigrantëve gjatë vitit 2011 u karakterizuan ndër komponentët e rëndësishëm në financimin e konsumit në vend. Zgjerimi i vazhdueshëm i aktivitetit të sektorit bankar paraqet gjithashtu një burim shumë të rëndësishëm për financimin e aktivitetit ekonomik në Kosovë. Aktiviteti kredidhënës i sistemit bankar vazhdoi të ketë normë dyshifrore të rritjes. Rritja e vazhdueshme e kreditimit dhe depozitave vazhdon të paraqesë sinjal të favorshëm sa i përket shkallës së stabilitetit të ekonomisë së vendit në përgjithësi dhe të sistemit bankar në veçanti. Sektori publik gjithashtu vazhdon të ketë rol pozitiv në stabilitetin e ekonomisë së vendit si në kuadër të të hyrave ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve buxhetore. Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me normë të lartë të papunësisë e cila paraqet sfidën kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social në vend. Normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit nuk po arrijnë të absorbojnë fuqinë punëtore në vend e cila vazhdimisht karakterizohet me rritje si rezultat i strukturës së re të popullsisë. Mbështjetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në importin e mallrave vazhdon të ketë kontribut negativ në normën e rritjes si dhe në deficitin e llogarisë rrjedhëse. Kjo sidomos vazhdon të shkaktohet nga rritja më e shpejtë e importeve krahasuar me rritjen e eksporteve. Presionet inflacioniste gjatë vitit 2011 vazhduan të jenë të pranishme në ekonominë e vendit. Presionet inflacioniste ishin më të shprehura në pjesën e parë të vitit, ndërsa ishin më të moderuara në pjesën e dytë të vitit 2011. Deri në vitet e shtatëdhjeta në mungesë të rrugëve të mira, në Kosovë kishte pak lëvizje turistike edhe pse Kosova ka pozitë të mirë gjeografike. Pas viteve të shtatëdhjeta me ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit rrugor automobilistik dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike, fillojnë lëvizjet turistike të shtohen. Turizmi ishte sektori tjetër që vuajti pasojat e konfliktit pasi askush, sado aventurier në shpirt, nuk do të merrte guximin të pushonte në zonën pranë konfliktit. Turizmi ka rëndësi për ekonominë dhe zhvillimin e vendit sepse ndikon në punësim. Po ashtu turizmi ka rëndësi të rëndësishme edhe në bilancin e pagesave. Bilanci i pagesave luan rol të rëndësishëm për secilin vend. Turistet e jashtëm të ashtuqytur ndërkombëtar konsumojnë shërbimet turistike duke vizituar vendet e ndryshme. Te mirat material dhe shërbimet. Duke blerë të mira material. Turizmi është veprimtari shërbyese në

të cilin mund të punësohen një numër i madh i popullsisë. Pasiqë në Kosovë dominon avantazhi i fuqisë punëtore më të re dhe më të lirë në rajon, Zhvillimi i turizmit është një motorë mjaftë i rëndësishëm për zbutjen e shkallës së papunësisë. Turizmi si veprimtari është me rëndësi sepse kërkon gjithnjë fuqi punëtore. Fuqia punëtore është me e pranishme ne vendet te cilat janë me pak të zhvilluara ekonomikisht. Gjatë vitit 2011, punësimi në Kosovë mund të ketë shënuar rritje, mirëpo rritja e vazhdueshme e fuqisë punëtore e bënë më të vështirë zvogëlimin e normës së papunësisë. Rritja e fuqisë punëtore në Kosovë vjen si rezultat i strukturës së popullsisë marrë parasysh se grupmoshat e reja përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së vendit. Struktura e popullsisë në Kosovë dominohet në masë të madhe nga grupi të cilët janë në moshë pune. Grupmosha prej 15-64 vjet përbën 65 përqind të gjithsej popullsisë. Grupmoshat nën moshën 15 vjeçare përbëjnë 28 përqind të popullsisë ndërsa më të vjetër se 65 vjet janë 7 përqind e popullsisë.¹⁰³ Ky është resursi mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, duke i përdor potencialet turistike ne diskonim qe ka vendi.

Ndikimet direkte dhe indirekte të turizmit në ekonomi

Turizmi dhe ndikimi i tij ne prodhimin shoqëror dhe ne te ardhurat nacionale shpreh ndikim te madh ne vende te ndryshme te cilat kanë ne funksion ofertën e mirëfilltë turistike. Turizmi ndikon ne te ardhurat nacionale, ku më rritjen e të ardhurave nacionale, pastaj kemi dhe ngritjen e zhvillimit të mirëqënies së qytetarëve të atij vendi, si dhe në ngritjen e konsumit. Efektet indirekte të turizmit janë të ndryshme. Paraqiten ne veprimtaritë ekonomike si ndërtimtari, industri dhe bujqësie. Efekti ne ndërtimtari manifestohet me fondet e investimeve në ndërtimin e objekteve akomoduese (hotele, motele, bujtina, rrugë, aeroporte, hekurudha, porte detare etj). Në këtë mënyrë ndërtimtaria ndikon ne rritjen e aktivitetit ekonomik, duke ndikuar në rritjen e të ardhurave në këtë veprimtari. Pra turizmi në mënyrë të tërthorte ndikon në zhvillimin e ndërtimtarisë. Efektet janë të shumta në mënyrë indirekte edhe ne zhvillimin dhe rritjen e prodhimeve industrial. Ndikime indirekt janë dhe artizanatet, Përpunimi i drurit, dhe mikpritja.

Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e turizmit

Pozita e mirë gjeografike, bukuritë natyrore dhe resurset e shumta ,klima, elementet hidrografike, mikpritja, përmirësimi i infrastrukturës, ekziston një rrjet rrugësh i zhvilluar plotesisht, pergjithesisht rruget jane me kushte shume te mir. Shume rruge kryesore lidhin qytetet e mëdha te Kosovës dhe territori i saj me vendet fqinj ka lidhje hekurudhore me Maqedoninë, Serbine, Lidhje te rregullta ajrore ndërkombëtare janë realizuar nga vendet Evropiane për ne Prishtine, ne kryeqytetin e Kosovës dhe teknologjisë, si dhe promovimi i turizmit janë faktorë të cilët ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e turizmit. Pengesat më të cilat përballët zhvillimi i turizmit janë: Mungesa e investimeve nga Qeveria dhe investitorët e huaj, niveli i ulët i sigurisë dhe sistemit ligjorë, moszhvillimi ekonomikë, problemet energjetikë, si dhe në imazh jo shumë i lakmuar nga e kaluara i Kosovës janë faktorë stagnues drejt një zhvillimi të qëndrueshëm turistik. Për këtë arsye

¹⁰³ F.Reçica & B. Millaku –Ekonomia e Turizmit Prishtinë 2011

² www.bqk-kos.org

³ <http://www.monitor.al/perfitime-ekonomike-nga-lufta/>

roli i marketingut është i pa zavedesueshem. Mu kjo do te ndihmonte ne përgatitjen e duhur te strategjisë se duhur ne zhvillimin e turizmit.

Përfundimi

Pasuritë dhe bukuritë e shumta natyrore janë element potencialë të shtytjes drejtë zhvillimit të turizmit, i cili është i lidhur drejtpërsëdrejti më zhvillimin ekonomik. Për turizmin mundë të konkludojmë se Kosova është një vend potencial sa i përket turizmit dhe mundësitë për zhvillimin e turizmit janë të shumta. Kosova si vend i dalë nga lufta e fund shekullit të kaluar përballët më shumë vështirësi dhe më një imazh jo shumë të favorshëm nga ana e ndërkombëtarëve sa i përket sigurisë. Investimi edhe më tutje në turizëm do të ishte një hapë i qëlluar drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm ekonomik. Kjo do te jap ekonomisë një shtytje drejt zhvillimit. Kështu do te përmirësohej standardi jetësor, duke u zbut papunësia dhe njëkohësisht duke u rrite mirëqenia sociale.

References

1. Adams, P.D. and B.P. Parmenter (1995), "An Applied General Equilibrium Analysis of the Economic Effects of Tourism in a Quite Small, Quite Open Economy," Applied Economics, Vol. 27, No. 10, 985-994.
2. Blake, A. (2000), "The Economic Effects of Tourism in Spain," Tourism and Travel Research Institute Discussion Papers, No. 2.
3. B. Millaku "Tema e Magjistarures" Prishtinë 2008.
4. F. Reçica & B. Millaku –Ekonomia e Turizmit Prishtinë 2011
5. F. Reçica & B. Millaku – Marketingu i udhetimeve turistike Prishtinë 2012
6. Blake, A. (2000), "The Economic Effects of Tourism in Spain," Tourism and Travel Research Institute Discussion Papers, No. 2. Magazine of the World Tourism Organization. ISSUE 3/2010.
7. Office for National Statics "Travel trend" Issued by: Office for National Statistics, Government Buildings -Cardiff Road-Newport NP10 8XG.
8. The International Centre for Responsible Tourism (Dr Harold Goodwin) and Scott Wilson Business Consultancy (Stuart Robson and Sam Higton), August 2004.
9. [World Tourism Organisation \(UNWTO\) Statistics Departament.](#)
10. M .Gashi : "Bazat e Turizmit"Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986.
11. M. Gashi "Vlerat turistike ne Kosovë" Plani regional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
12. M. Gashi : "Uslovi i mogënosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
13. M. Gashi : "Osnovni potencial turističkih vrednosti Kosova",ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.
14. N. Muhaxheri : Ekonomika dhe Menaxhmenti në Turizëm-Prishtinë 2005.

Websites

1. www.bqk-kos.org
2. <http://www.monitor.al/perfitime-ekonomike-nga-lufta>.
3. <http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/kosovo/infrastructure.html>.